



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26 Janar 2022

Nr: 15

V E N D I M

P Ë R

**DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 9.6.2021, TË KOMISIONERIT SHTETËROR
TË ZGJEDHJEVE, “PËR CAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAT PËR
PËRZGJEDHJEN DHE EMËRIMIN E EKSPERTËVE KONTABËL TË LICENSUAR
(AUDITUESVE LIGJORË) DHE KUSHTET KONTRAKTUALE PËR AUDITIMIN E
FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA PARTITË POLITIKE GJATË
VITIT KALENDARIK DHE SUBJEKTET ZGJEDHORE DHE KANDIDATËT E TYRE NË
FUSHATËN ZGJEDHORE”**

Në mbështetje të neneve 19 pikat 1, shkronja “ë”, e 2, 92/6 pika 3, dhe 92/7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 23/2 e 23/3, të ligjit nr. 8580 datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore” bëhen shtesat si më poshtë vijon:

- a) Në nenin 1, shkronja “b” dhe nenin 3, pika 2, pas fjalëve “...kandidatët e tyre...” shtohet “...kandidatët për kryetar bashkie dhe këshilla bashkiakë...”.
- b) Në nenin 6, pika 2 dhe nenin 7, pikat 3 e 4, pas fjalëve “...kandidatët e propozuar nga zgjedhësit...” shtohet “...kandidatët për kryetar bashkie dhe këshilla bashkiakë...”.
- c) Pikat 1 dhe 2, të nenit 5, të kontratës së shërbimit për auditimin vjetor të partive politike që referohet në pikën 8 të nenit 6, ndryshohen si më poshtë vijon:

“1. Pagesat do të kryen në monedhë shqiptare (Lekë), sipas të dhënave të mëposhtme:



- a) Emërtimi i llogarisë: _____
- b) IBAN-i i llogarisë: _____
- c) Emri i bankës: _____

2. Për shërbimin e kryer nga Ofruesi i Shërbimit do të lëshohet një faturë elektronike e fiskalizuar.”.

- d) Neni 5, i kontratës së shërbimi për auditimin e fushatës zgjedhore që referohet në pikën 8 të nenit 6, ndryshohen si më poshtë vijon:

“Neni 5

Mënyra e pagesës

1. Pagesat do të kryen në monedhë shqiptare (Lekë) sipas të dhënave të mëposhtme:

- a. Emri i llogarisë: _____
- b. IBAN-i i llogarisë: _____
- c. Emri i bankës: _____

2. Për shërbimin e kryer nga Ofruesi i Shërbimit do të lëshohet një faturë elektronike e fiskalizuar.

3. Fatura së bashku me dokumentacionin mbështetës do të dorëzohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

4. Pagesa do të kryhet me urdhër shpenzim pas miratimit nga DKFAB të kryerjes së shërbimeve të kontraktuara. Porositësi është i detyruar të paguajë çmimin e caktuar në nenin 4 të kësaj kontrate, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e marrjes në dorëzim të faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimit.”.

- 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga data e publikimit.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

